

**Burimet:** deklarata S.B, FDH-15132; deklarata S.M, FDH-15572; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

### Jahir (Brahim) Shabani

(14.09. 1964, shqiptar nga fshati Bubël/Bublje, komuna e Malishevës/Mališevo, bujk, tre fëmijë)

Në fillim të muajit maj të vitit 1998, te Jahiri erdhi motra Ajshe nga fshati Zajmovë/Zajmovo. Së bashku me familjen e vet, ajo e kishte braktisur fshatin për shkak të pranisë së shtuar të forcave serbe në fshatin e saj. Pas dy javësh, Ajshja me bashkëshortin u kthyen në shtëpi, përderisa fëmijët e tyre ndenjen te Jahiri. Në datën 15.05.1998, Jahiri shkoi për në Zajmovë/Zajmovo për të kontrolluar nëse djali i Ajshes, Fadili, kishte arritur te prindërit. Pasi u bind se Fadili kishte arritur në shtëpi dhe çdo gjë ishte në rregull, Jahiri vendosi që natën ta kalonte te motra. Herët në mëngjes, nga ora 7:00 [16.05.1998], ai u nis për në shtëpi. Po atë ditë, por pas disa orësh, dy shqiptarë, një nga Zajmova/Zajmovo dhe i dyti nga Damaneku/Domanek [Glogoc/Glogovac], e sollën trupin e pajetë të Jahirit te shtëpia e vëllait të tij Isait. Shefi i Stacionit Policor në Klinë/Klina u kishte urdhëruar atyre që pranë shtëpisë së Maliq Morines në Zajmovë/Zajmovo ta merrnin trupin e Jahir Shabanit dhe ta çonin në Bubël/Bublje [Malishevë/Mališevo]. Në trupin e Jahirit shiheshin plagët nga armë zjarri. Po atë ditë, familjarët e kanë varrosur Jahirin në varrezat lokale, ku prehet edhe sot.

**Burimet:** deklarata I.Sh, FDH-33467; KMDLNJ, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 153, FDH-23816.

### Ramadan (Halil) Morina

(1.10.1961, shqiptar nga Rigjeva/Ridevo, komuna e Klinës/Klina, murator, katër fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

### Sefer (Halil) Morina

(10.04.1964, shqiptar nga Rigjeva/Ridevo, komuna e Klinës/Klina, murator, pesë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Vëlëzerit Ramadani dhe Seferi me familjet e veta jetonin në *Mëhallën Loshaj* në **Rigjevë/**

**Ridevo**. Kanë qenë pjesëtarë të UÇK-së. Në mëngjesin e datës **17.05.1998**, jo shumë kohë pas kthimit të Ramadanit dhe Seferit nga ndërresa e natës, forcat serbe kanë hyrë në fshat. Ramadani, Saferi dhe vëllai i tyre i tretë, Sylejmani, dolën jashtë shtëpisë për të parë çfarë po ndodhte. Në atë çast, pjesëtarë të forcave serbe kanë hapur zjarr drejt tyre nga automjetet e blinduara. Ramadani dhe Seferi u qëlluan dhe gjetën vdekjen në vend. Sylejmanin e kanë arrestuar, por e liruan pas disa orësh. Në orët e vona të mbrëmjes, Sylejmani me ndihmën e disa bashkëfshatarëve i kanë marrë trupat e Ramadanit dhe Seferit, dhe i kanë çuar në fshatin fqinj të Zabërgjë/Zabrde, Atje, ata u varrosën në varrezat lokale.

**Burimet:** deklarata M.M, FDH-31855; deklarata Sh.M, FDH-33464; KMKRFJ, *Persona...*, FDH-10832.

### Brahim (Demush) Morina

(1.02.1950, shqiptar nga Rigjeva/Ridevo, komuna e Klinës/Klina, punëtor ndërtimor, pesë fëmijë)

Në fillim të muajit maj të vitit 1998, Brahimi e ka transferuar familjen e tij në Obri të Ulët/Donje Obrinje [Skënderaj/Srbica], ndërkaq ai ndenji në shtëpinë e vet, në *Mëhallën Loshaj*. Ishte kjo hera e fundit që familjarët e shihnin të gjallë. Në mëngjesin e datës **17.05.1998**, forcat serbe kanë hyrë në **Rigjevë/Ridevo**. Nga ora 18:00, komshiu i tyre, Agim Pantina, i ka njoftuar familjarët se Brahimin e kishin vlarë në oborr. Po atë ditë, trupi i Brahimit, së bashku me ata të vëllezërve Morina, është bartur në Zabërgjë/Zabrde, ku që të tre u varrosën në varrezat lokale. Brahim prehet atje edhe sot.

**Burimet:** deklarata M.M, FDH-31855; deklarata Sh.M, FDH-33464; KMKRFJ, *Persona...*, FDH-10832.

### Ivan (Trajko) Zarić

(31.07.1974, serb nga Dollci/Dolac, komuna e Klinës/Klina, rojtar)

### Burim (Ramadan) Bejta

(15.04.1982, rom nga Dollci/Dolac, komuna e Klinës/Klina, punëtor)